



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial
Council

Datë: 02 maj 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 10, nenit 14, nenit 16 dhe nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, nenit 7 të Rregullores Nr. 03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, si dhe Vendimin KPK/Nr.290/2025, të datës 30 prill 2025, shpall:

SHPALLJE E BRENDSSHME

Për Transferimin e përhershëm të dy (2) prokurorëve të Shtetit në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

1. Prokurori i Shtetit mund të transferohet nga Departamenti për të Mitur i Prokurorisë Themelore në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë themelore të njëjtë apo prokurorisë tjetër ose anasjelltas.
2. Prokurorët e Shtetit duhet të plotësojnë kriteret për transferim të përhershëm si në vijim:
 - Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
 - Të ketë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë;
 - Vlerësimi “ I mjaftueshëm” sipas Rregullores Nr.12/2015 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në Vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr.05/2020 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të Shtetit;
 - Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht vërejtjes jopublike, përveç nëse transferimi është bërë me vendim të Këshillit Prokurorial të Kosovës si masë disiplinore.
3. Komisioni merr parasysh me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm edhe përvojën e punës dhe vendbanimin e kandidatit.

4. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendimi i kryeprokurorit të prokurorisë, nga e cila kërkohet transferimi.
5. Kandidati që aplikon për Transferim të përhershëm, duhet të plotësojë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit¹ si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
 - Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre (3) vitet e fundit;
 - Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 - Dokumentet apo të dhëna të tjera relevante ose objektivisht të verifikueshme siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.
6. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
7. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 5 maj 2025 deri më 19 maj 2025.
8. Kërkesa duhet të dorëzohet tek Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, z. Sami Istrefi, në katin e katërt (4), ndërtesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Rruga “Luan Haradinaj”, Prishtinë, zyra numër 407, të mbyllura me zarf ose me postë.

¹ Prokurorët të cilët aplikojnë për transferim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit të cilin mund ta gjejnë në linkun <https://prokuroria-rks.org/shpallje-dhe-njoftime/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.